




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr Prot. Br Prot. <u>01-2965/14</u>
Nr. I faq. Broj stranica <u>03</u>	Data Datum <u>22-08-2014</u>
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 18 (paragrafi 4, 8 dhe 12) të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 21.08.2014 mori:

V E N D I M

I. Ekziston konflikti i interesit në rastin Nr. AKK -03-1769/14, për z. Srecko Spasic, Kryetar i Komunës së Klllokotit dhe si person i autorizuar në një ndërmarrje private.

II. Agjencia do të kërkoj nga institucioni ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij.

III. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

A r s y e t i m

I. Bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, neni 18 paragrafi 1 dhe 3, si dhe në bazë të vendimit Nr (03-1769/14), është hapur rasti nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi për zyrtarin e lartë, z. Srecko Spasic – Kryetar i Komunës së Klllokotit, i cili ushtron funksionin si person i autorizuar në ndërmarrjen private P.T.U “Aqua Sana”.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (AKK-DPK-01-1892/14), me datë 27.05.2014. Pas pranimit të kësaj shkrese, ai është kontaktuar nga Agjencia kundër Korrupsionit për tu njoftuar me situatën në të cilin ndodhet dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Spasic, është këshilluar që gjatë ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë nuk mund të ushtroj funksion menaxhues në ndërmarrje private, dhe për të shmangur konfliktin e interesit duhet të bartë menaxhimin e biznesit tek një person i besuar (jo person i afërt i familjes).

Kjo si pasojë e asaj se ushtrimi i funksionit publik si Kryetar i Komunës së Klllokotit dhe njëkohësisht të qenurit person i autorizuar në ndërmarrjen private P.T.U “Aqua Sana”, bie ndesh me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Nr.04/L-051), konkretisht me nenin 15 (paragrafi 1) të këtij ligji i cili shprehimisht thotë:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private”.

Përkunder afatit ligjor të dhënë nga Agjencia, zyrtari i lartë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të shmangur Konfliktin e Interesit, prandaj Agjencia i ka bërë shkresën e dytë sipas procedurës ligjore që quhet “njoftimi paralajmërues” (AKK-01-2562/14), datë 09.07.2014, me të cilin zyrtarit të lartë i është bërë e qartë se duhet të shmanget situata e Konfliktit të Interesit brenda afatit të caktuar, përndryshe do të pasojnë masat sanksionuese të parapara me Ligj.

Pas pranimit të shkresës paralajmëruese zyrtari i lartë z. Spasic, përkundër rekomandimit të Agjencisë që menaxhimi i biznesin nuk mund të bartet tek personi i afërt i familjes, ai nuk e ka përfillur këtë rekomandim duke caktuar personin e autorizuar të biznesit të tij një person të afërt të familjes.

Zyrtari i lartë është kontaktuar përsëri nga Agjencia për tu njoftuar se ndryshimi i bërë në ndërmarrjen private, nuk mjafton për faktin se i njëjti nuk është në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, dhe përkundër kërkesës për takim nga z. Spasic, ai nuk i është përgjigjur pozitivisht, nuk ka bashkëpunuar me zyrtarët e Agjencisë dhe as nuk ka ndërmarrë veprime për të shmangur gjendjen e Konfliktit të Interesit.

Prandaj, duke pasur parasysh këto rrethana vlerësojmë se zyrtari i lartë z. Srecko Spasic nuk e ka shmangur gjendjen e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në rast se personi zyrtar i lartë vazhdon të kryej aktivitete apo funksione të papajtueshme sipas këtij ligji, pavarësisht nga paralajmërimi i Agjencisë, atëherë Agjencia i kërkon institucionit ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij (neni 18 paragrafi 8).

III. Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e funksionit Publik (Nr.04/L-051) Neni 20, pika 1, çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuara në paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3.

Sipas nenit 20 pika 2, “Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtari i lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përveç dënimit gjykata mund ti shqiptoj edhe masën mbrojtëse; ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit”


IV. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./ znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

U skladu sa članom 11. (stav 1.1) , članom 5 (stav 1 tačka 1.5) Zakona br . 03/159 za Agenciju protiv Korupcije , člana 18 (stav 4 , 8 i 12) Zakona br . 04 / L - 051 za Sprečavanje Sukoba Interesa u Vršanju Javnih Funkcija , kao i članu 19 (stav 11) Uredbe br .01/2014 o radu Agencije protiv Korupcije 01/2014 , Direktor Agencije protiv Korupcije je dana 21.08.2014 doneo sledeće:

R E Š E N J E

I. Postoji sukob interesa u slučaju br . APK -03-1769 / 14 , za g. Srećko Spasića , Predsednika Opštine Klokot i ovlašćeno lice u privatnom preduzeću .

II. Agencija će tražiti od institucije gde visoki zvaničnik vrši funkciju , da započne sa procedurom za njegovo razrešenje.

III. Sve odluke koje se donose od strane Agencije u vezi sukoba interesa , bit će objavljeni na zvaničnom sajtu Agencije..

O b r a z l o ž e n j e

I. Na osnovu Zakona o Sprečavanju Sukoba Interesa u Vršanju Javne Funkcije Br.04/L-051, članu 18 stav 1 i 3, kao i na osnovu odluke Br.(03-1769/14), otvoren je slučaj pod sumnjom za Sukob Interesa za Visokog zvaničnika Srećka Spasića, Predsednika Opštine Klokot, koji vrši funkciju kao ovlašćeno lice u privatnom preduzeću P.T.U "Aqua Sana".

Visoki zvaničnik je prvo obavešten službenim pismom od strane Agencije protiv Korupcije za početak razmatranja mogućeg stanja sukoba interesa (APK-DSK-01-1892/14), dana 27.05.2014. Po prijemu pisma, on je kontaktiran od strane Agencije protiv Korupcije da bi se upoznao sa stanjem na kojem se nalazi i izmene koje treba da učini da bi se izbeglo stanje sukoba interesa.

Visoki zvaničnik g.Spasić je savetovan da tokom vršenja javne funkcije kao visoki javni zvaničnik ne može da istovremeno vrši funkciju upravljanja u privatnom preduzeću i da bi se

izbeglo stanje sukoba interesa treba da prenese upravljanje na neko povereno lice(ne neposredna porodična osoba).

To je zbog činjenice da je vršenje javne funkcije kao Predsednika Opštine Klokot i istovremeno biti ovlašćeno lice u privatnom preduzeću P.T.U "Aqua Sana" je u suprotnosti sa Zakonom o Sprečavanju Sukoba Interesa u Vršnju Javne Funkcije (br.04/L-051), konkretno sa članom 15(stav 1) ovog zakona koji izričito kaže:

"Visoki zvaničnik ne može biti menadžer, član nekog upravnog odbora ili upravnik privatnih preduzeća"

Uprkos datom roku od strane Agencije, visoki zvaničnik nije preduzeo nikakve mere da bi izbegao sukob interesa, pa je Agencija poslala drugo pismo po zakonskoj proceduri pod nazivom "upozorenje"(APK -01-562/14), poslato dana 09.07.2014, gde je visoki zvaničnik jasno upozoren da treba da izbegne situaciju sukoba interesa u određenom roku, inače će biti suočen sa predviđenim Zakonskim merama.

Po prijemu upozoravajućeg pisma, visoki zvaničnik g. Spasić je uprkos preporuci Agencije da upravljanje privatnim biznismom ne može preneti licu bliskom porodici, on nije prihvatio preporuku o imenovanju ovlašćenog lica, imenjujući ovlašćeno lice za biznis na lice bliskog porodici.

Visoki zvaničnik je ponovo kontaktiran od Agencije, da bi se upoznao da izmenom koja je izvršena u privatnom preduzeću nije dovoljna zbog činjenice što nije u skladu sa Zakonom za Sprečavanje Sukoba Interesa, i uprkos zahtevu za sastanak sa g.Spasićem, on se nije pozitivno odazvao, nije sarađiva sa službenicima Agencije. I nije preduzeo nikakve mere da bi se izbeglo stanje sukoba interesa.

Dakle, s obzirom na te okolnosti, mi procenjujemo da visoki zvaničnik g.Srecko Spasić nije izbegao sukob interesa u vršenju javnih funkcija.

II. U slučaju da visoki zvaničnik i dalje nastavlja sa vršenjem aktivnosti ili funkcije u neskladu sa ovim zakonom, nezavisno od upozorenja od Agencije, Agencija traži od institucije gde visoki zvaničnik vrši funkciju da započne proceduru o njegovom smenjivanju (član 18 stav 8).

III. Prema Zakonu o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija (No.04 / L-051) Član 20, stav 1, svako kršenje obaveza propisana ovim zakonom, kada ne postoji krivično delo je prekršaj i kažnjivo je novčano u granicama predviđenim po stavovima 1.1, 1.2 1.3

U skladu sa članom 20, stav 2, " za povrede obaveza utvrđenih ovim zakonom, javnog funkcionera, menadžera ili rukovodioca institucije, pored kazni sud, takođe može da izrekne zaštitnu meru; zabrana vršenja javne funkcije u periodu od tri (3) meseca do jedne (1) godine "

IV. Stoga je odlučeno kao u izreci ove odluke.

Odluka se dostavlja:

- Visokom javnom zvani
- Direktor DSK-
- G./g-đi (odgovorni službenik)
- G/ g-đi (pomoćnom službeniku)

Hasan Preteni

Direktor Agencije protiv Korupcije